



RAPORTI MUJOR

Muaji prill 2009

Bordi i ZRRE-së

Gjatë muajt prill Bordi i ZRRE-së ka mbajtur 3 seanca gjatë të cilave ka shqyrtuar dhe ka marrë vendim për këto çështje:

- Ankesat e Konsumatorëve
- Është marrë vendim për plotësimin e vendeve të lira të punës në ZRRE për Kryesues të Departamentit Ligjor dhe të Licencimit (DLL) si dhe pozitën për Kryesues të Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve.
- Është miratuar lista e taksave për shqyrtimin e aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese
- Janë aprovuar kërkesat e Ngrohtores së qytetit të Gjakovës dhe Termokosit të Prishtinës për ekspertë të pavarur
- Është shqyrtuar dhe është aprovuar kërkesa e NQ Termokos për shtyrjen e afateve (derogime) të disa neneve të licencave
- Është bërë amendamenti i Kodit të Pajisjeve Elektrike
- Është aprovuar Kodi i Matjes të NQ Gjakova; dhe Kodi i Qasjes në Tokë dhe Ndërtesa.
- Janë aprovuar tarifimet me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të zbatohen nga KEK-SH.A. prej datës 01 prill 2009
- Është marrë vendim për tu bërë harmonizimi i të hyrave të Buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009,
- Është vazhduar vlefshmëria e Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dhe të Procedurës për Faturim dhe Lexim të konsumatorëve shtëpiak
- Në takim të veçantë është diskutuar rreth letrës së dërguar nga Kompania Wind Power SH.A

Aktivitetet e veçanta të departamenteve të ZRRE-së

Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave

- Me 2 prill është bërë shqyrtimi i komenteve dhe përgatitja e përgjegjëjeve ndaj komenteve të pranuar nga palët e interesit mbi Raportin Konsultativ të Shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike 2009.
- Është përgatitur Raporti i tarifave të energjisë elektrike 2009, për takim me Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.
- Me 09 prillë anëtarja e Bordit, dhe kryesuesja e Departamentit, Theranda Beqiri ka marrë pjesë në takimin e përbashkët të grupit punues të tarifave dhe çmimeve të Asociacionit Regjional të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA), në Varshavë të Polonisë dhe ka mbajtur prezantim për "Vendosja e tarifave në mënyrë jo diskriminuese".
- Me 16 prill është përgatitur dokumenti me sqarime për kostot dhe të hyrat e KOSTT dhe Furnizuesit publik.



- Me 25 prill është zhvilluar analizë për kompaninë “AIR ENERGY” mbi kthimin (në kohë) të investimeve dhe të Hyrat që pret të merr me shkallë të ndryshme të shfrytëzimit të kapacitete për gjeneratorët e erës.
- Me 27 prill 2009 janë përgatitur komentet e ZRRE, ndaj letrës së datës 23 prill 2009 të KEK ShA .

Aktivitetet lidhur me Ngrahjen Qendrore dhe Gazin

- 01/04/2009 Pjesëmarrja në takimin përgatitor në MEM për vizitën (“Country mission”) e përfaqësuesit të Sekretariatit të TKE EJK – tema e takimit progresi në plotësimin e obligimeve lidhur me gazin natyror dhe Burimeve të ripërtrishme të energjisë. (Astriti)
- 16/04/2009 Përgatitja e komenteve për Projektligjin e Gazit natyrorë.
- 17/04/2009 Mbledhje stafit në ZRRE lidhur me Projektligjin për Gazin Natyror. Diskutim dhe përmbledhje e komenteve nga i gjithë stafi përkatës me që rast u krijua versioni final i këtij draft ligji.
- 22/04/2009 Takimi në MEM me përfaqësuesin e TKE EJK – takimi sipas agjendës së paraparë, ndër tjera edhe diskutimi për Projektligjin e Gazit Natyror (Astriti)

Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK)

- DMK gjatë muajit prill, 2009 ka regjistruar **28** ankesa të konsumatorëve, ka zgjidhur 18 ankesa, ka pasur **87** biseda direkte me palë, dhe ka pasur **13** biseda telefonike, me konsumatorë
- Me datë 01.04.2009, është mbajtur një takim me konsulentin e NERA-s Dennis Colenutt lidhur me raportet që duhet të dorëzohen në ZRRE lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve.
- Me datë 02.04.2009, përfaqësuesi i DMK ka marrë pjesë në takimin e gjashtë të Grupit Punues për standarde e kualitetit të furnizimit dhe kualitetit të shërbimit.
- Me datë 06.04.2009, përfaqësuesi i DMK ka mbajtur takim me përfaqësuesin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, zyrtarin për Rregullimin e Tregut dhe Mbrojtjen e Konsumatorit lidhur me procedurat dhe rregullat e mbrojtjes së konsumatorëve
- Me datë 14.04.2009, përfaqësuesi i DMK ka marrë pjesë në takimin e mbajtur me stafin e ZRRE-së lidhur me procedurat e ndryshme të arritur nga KEK-u në ZRRE, Procedura e Leximit dhe faturimit
- Me datë 27.04.2009, përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur mes ZRRE-së dhe Zyrën Ligjore të KEK-ut lidhur me procedurat dhe rregullat e ankesave të konsumatorëve.
- Me datë 29.04.2009, përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur mes ZRRE-së dhe KEK-ut lidhur me ndryshimin e Rregullave të iniciuara nga ZRRE dhe procedurave tjera.

Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut

- Me 02 Prill 2009 pjesëmarrje në takimin e 6 të grupit punues për propozimin e standardeve të kualitetit të furnizimit dhe shërbimeve, në ZRRE
- Me 22 dhe 23 Prill 2009 Kryesuesi i DFEST ka marrë pjesëmarrje në takimin në Athinë në SEE CAI IG.



- Me 24 prill përfaqësuesit e këtij Departamenti kanë marrë pjesë marrje në takimin në KOSTT për anëtarësimin e KOSTT-it në asociacionin Evropian ENTSO-E dhe mekanizmat regjional
- Me 29 prill përfaqësuesit e DEFST kanë marrë pjesë në takimin në MEM të grupit punues për hapjen e tregut HTEE- analiza e draft dokumentit është në përpunim.
- Me 29 prill pjesëmarrje në takimin në ZRrE me KEK-un për procedurat për kyqje, kushtet e përgjithshme për furnizim me energji, zgjidhja e kontesteve dhe kontratat e KEK-ut.
- Gjithashtu është punuar në dokumentin për hapje të tregut, në kuadër të grupit punues HTEE dhe materiale tjera si të nivelit rajonal po ashtu edhe të akterëve energjetik. Është punuar si zakonisht dhe në raportet mujore dhe ditore të KEK-ut, ato të KOSTT-it, dhe punë tjera standarde dhe të përhershme.

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit

- Me 1 prill është mbajtur takim me përfaqësuesit e kompanisë “Akidu” Bullgari, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Licencën Furnizim/Tregti me energji elektrike.
- Me 7 prill është mbajtur takim me përfaqësuesin e kompanisë AIR ENERGY lidhur me aplikacionin për ndërtim të gjeneratorit që prodhon energji. elektrike. nga era.
- Me 7 prill është mbajtur takim me përfaqësues të KEK-ut lidhur me Kodin e qasjes në toka dhe ndërtesa
- Me 21, 22, dhe 24 prill janë mbajtur takime të Grupit Punues të ZRRE-së lidhur me vlerësimin e aplikacionit për Autorizim të kompanisë Air Energy Shp.k Gjilan.
- Me 25 prill është mbajtur takim me stafin e ZRRE-së lidhur me ndryshimin e legjislacionit sekondar të ZRRE-së.
- Me 28 prill është mbajtur takim me stafin e ZRRE-së lidhur me Kodin e qasjes në tokë dhe ndërtesa.
- Me 29 prill është mbajtur takim me përfaqësues të KEK-ut dhe në prezencën e përfaqësuesit të USAID lidhur me ndryshimin e tri rregullave (RZK, RKPFE dhe RSHRKSE).
- Me 29 prill është mbajtur takim me përfaqësues të KEKLOS/Kosovë lidhur me transferimin e licencës për gjenerim të energjisë elektrike nga Triangle në KELKOS.
- Me 29 prill është mbajtur takim i Grupit Punues të ZRRE-së lidhur me vlerësimin e aplikacionit për Autorizim të kompanisë WIND POWER sh.a.

Departamenti i Administratës

- janë kryer pagesa për:
 - a. paga në shumë prej 24,154.20 euro
 - b. mallra dhe shërbime20,295.76 euro
 - c. shërbime komunale.....517.89 euro
- janë tërhequr dy avanse për udhëtime zyrtare jashtë vendit, ndërsa tri tjera janë mbyllur.
- është kryer regjistrimi i të hyrave në sistemin e free- balancit.
- është përgatitur raporti tremujor i shpenzimeve buxhetore.
- Hapja e ofertave për aktivitetin e prokurimit “Publikimi i njoftimeve dhe shpalljeve ne shtypin ditor-ritender”, date 01.04.2009. Formimi i komisionit të vlerësimit dhe vlerësimi i ofertave, përgatitja e njoftimeve për KRPP dhe për 7 kompanitë konkurruese për anulim të tenderit.



- Përgatitja dhe nënshkrimi i kontratës për furnizim me derivate për nevoja të ZRRE, datë 17.04.2009.
- Inicimi i aktivitetit të prokurimit “Shërbimet e dizajnit, shtypjes, fotokopjimit të dokumenteve, raportit vjetor, fletushkave etj”, datë 08.04.2009. Hapja e ofertave me datë 17.04.2009. Formimi i komisionit vlerësues, vlerësimi i ofertave me datë 21.04.2009 dhe dhënia e kontratës kompanisë „Adnan Reznici“, përgatitja e njoftimeve për dhënie të kontratës për KRPP, dhe njoftimi zyrtar i kompanive lidhur me këtë aktivitet prokurimi. Përgatitja e kontratës për nënshkrim (nënshkrimi i saj është bërë me 4 maj).
- Përgatitja e dosjes së tenderit dhe inicimi i aktivitetit të ri të prokurimit për “Publikim të njoftimeve në shtypin ditor-ritender1”, datë 24.04.2008.
- Nxjerrja e urdhër-blerjeve në sistem të Thesarit për pagimin e faturave të rregullta për kompanitë me të cilat kemi kontratë.
- Angazhimi në përgatitjen e specifikacioneve për projektin “Zhvillimi i sistemit menaxhues të dokumenteve dhe informatave për ZRRE”
- Furnizimi i zyrës me gjëra të tjerat të nevojshme
- Janë zbatuar procedurat e rekrutimit për plotësimin e dy pozitave të reja
- Është dhënë përkrahje e përgjithshme administrative Departamenteve profesionale
- Është bërë Organizimi i seancave të Bordit
- Monitorimi i përditshëm i mediave dhe kontaktet me gazetarë
- Aranzhimet e udhëtimeve të ekspertëve që janë anëtar në grupet punuese të asociacioneve rajonale(ERRA ECRB) si dhe janë zhvilluar përgatitjet për udhëtimin e partneritetit në Komisionin Komercial të Illinoisit SHBA në të cilin do të marrin pjesë 5 pjesëmarrës të ZRRE-së

Aktivitete të tjera të ZRRE-së

- Me 1 prill 2009 është mbajtur takimi me përfaqësuesit e projektit për ZRrE të financuar nga Banka Botërore.
- Me datë 2 prill 2009, është mbajtur takimi i Komitetit Drejtues të NERA (Projekt për mbështetje Teknike ZRRE-së i financuar nga Komisioni Evropian), ku është prezantuar raporti i parë i progresit. në takim kanë marr pjesë Anëtarët e Bordit dhe personat përgjegjës për secilën pikë të projektit.
- Me 3 prill 2009 është mbajtur takimi në ZRRE për Rishikimin e pjesës narrative të PVPE(Plan Veprimi për Partneritetin Evropian)
- Me 6, 7, 8,dhe 9 në Varshavë të Polonisë, Kryesuesi i Bordit Z. Ali Hamiti dhe anëtari i Bordit Blerim Koci kanë marrë pjesë në Konferencën e ERRA për Investime dhe Rregullim të Energjisë, në Asamblenë e përgjithshme të këtij asociacioni dhe grupin punues të Bordeve dhe të Licencimit gjithashtu që i përkasin këtij asociacioni, anëtare e të cilit është edhe ZRRE-ja.
- Me 30 Prill 2009 është mbajtur takim lidhur me komentet për ECRB në materialin “ECRB EWG Benchmarking Report on compliance With Regulation (EC) No 1228/2003 and the Congestion Management Guidelines”.